



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 dhe 21 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE TË KLUBEVE
SPORTIVE DHE OJQ- VE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE**

Neni 1

Formimi i Komisionit dhe përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të klubeve sportive dhe OJQ-ve të ndryshme të cilat aplikojnë sipas Thirrjeve publike për aplikim të shpallura nga Komuna e Lipjanit për relizimin e projekteve të ndryshme në interes të Komunës, në këtë përbërje:

1. Mergim Oruçi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Vlora Krasniqi, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare
3. Gafurr Hetemi, Sektori pronësor-juridik, anëtar
4. Armend Duriqi, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar rezerv

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati Komisionit

Komisioni i ankesave ka mandat të shqyrtoj ankesat ndaj vendimeve për moskualifikim si rezultat i mospërmbushjes së kriterëve procedurale të kriterëve procedurale të parapara me nenet 10 dhe 11 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe ankesat ndaj vendimeve përfundimtare në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të mbështetjes financiare.

Komisioni i ankesave vendos lidhur me ankesën në afat prej pesë (5) ditësh nga dita e pranimit të saj.

Komisioni i ankesave nxjerr Vendim për të pranuar ose refuzuar ankesën.

Vendimi i Komisionit të ankesave është përfundimtar në procedurë administrative.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të ankesës dhe Komisionit vlerësues.

Komisioni i ankesave mban procesverbal për të gjithë procesin e trajtimit të ankesave dhe
vendimarrjes.

Komisioni ka mandat 2 vjeçar.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij
Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.
Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e Komisionit për
shqyrtimin e ankesave të klubeve sportive dhe OJQ-ve të ndryshme për ndarjen e
subvencioneve INr.660-48433 i datës 06.10.2020

INr. 453 - 49738

Lipjan, më 12.10.2020

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti

